



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 381/6 prot.

Tiranë, më 19.9.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 681, datë 7.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Artur Ismajlukaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 4.9.2023, është njoftuar vendimi nr. 681, datë 7.7.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Artur Ismajlukaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 4.9.2023, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, datë 4.9.2023, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 681, datë 7.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Ismajlukaj, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Ismajlukaj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*) nga të cilat rezulton se:

2.1 *ILDKPKI*, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Artur Ismajlukaj*”,² ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 *DSIK*, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë **.11.2017³, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Ismajlukaj*”, raport i hartuar pa përgjigjen e organit verifikues SHISH. Komisioni, në vijim të hetimit administrativ, ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga DSIK në vitin 2017. DSIK ka dërguar⁴ një raport të dytë, në qershor të vitit 2021, ku ka përfshirë informacion në kohështirje përpara dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, nga ku ka rezultuar përfshirja në veprimtari të kundërligjshme e subjektit të

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.1.2018.

³ Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. **, datë **.1.2023.

⁴ Me shkresën *** prot., datë **.6.2021, është dërguar raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. *** prot., datë **.5.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë **.6.2021.

rivlerësimin në sistemin e drejtësisë. Në përfundim, DSIK, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në *papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Artur *** Ismajlukaj*.

2.3 *KLP*, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁵ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, z. Artur Ismajlukaj.

2.4 *Gjetjet e ONM-së*. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni më datë 28.2.2023, ka protokolluar shkresën nr. *** prot., me objekt *Gjetje*, të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar, bazuar në nenin B, pika 3, germa “b”⁶, të aneksit të Kushtetutës dhe nga neni 49, pika 10⁷, e ligjit nr. 84/2016, në të cilën janë referuar disa situata për t’u marrë në konsideratë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit të subjektit, pasi mund të cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** [...] Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...].

3.2 **Për kontrollin e figurës.** [...] Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...].

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...] Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 [...].

4. **Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Artur Ismajlukaj.*

⁵ Raport i KLP-së nr. *** prot., datë **3.2019.

⁶ [...] 3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH ...

⁷ [...] Gjetja, e paraqitur në formën e një deklarate, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelit [...].

- Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të referojë pranë organit kompetent ILD, bazuar në nenin 103/ç, mbi “sjelljen e magjistratit jashtë ushtrimit të funksionit”, të ligjit nr. 96/2016; për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me subjektin e rivlerësimit.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁸ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁹ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 4.9.2023, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr. 381/2 prot., aktin: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 681, datë 7.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Artur Ismajlukaj (bashkëlidhur dhe pjesë e këtij ankimi).

5.1 ONM, në konkluzion të këtij rekomandimi, në mënyrë të përmbledhur, referon se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin publik në sistemin gjyqësor, besim të cilin procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve synon ta rikthejë. Nga hetimi administrativ në Komision ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit kishte kontakte direkte apo indirekte me shtetas të përfshirë në veprimtari kriminale, të cilat bien ndesh me etikën dhe sjelljen e kërkuar nga një magjistrat, për të kaluar procesin e rivlerësimit dhe për t’u konfirmuar në detyrë sipas nenit 59, prg. 1, germa “c”, e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, ONM-ja rekomandon ankimin e vendimit të Komisionit, që konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Artur Ismajlukaj, lidhur me vlerësimin e etikës së subjektit të rivlerësimit, së bashku me referimin e çështjeve sipas nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet

⁸ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁹ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

9. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 681, datë 7.7.2023, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

10. Për sa më sipër, në konsideratë të faktit se Kolegji ka juridiksionin e posaçëm dhe të vetëm për të përcaktuar kualifikimet ligjore për çështjet që i përkasin procesit të rivlerësimit, juridiksion i cili lejon Kolegjin që të përcaktojë ligjërisht çdo rrethanë fakti nën parashikimet e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik, duke mbajtur në vëmendje dhe Rekomandimin e ONM-së, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 681/2023 të Komisionit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

11. Komisioneri Publik, mbështetur në jurisprudencën¹⁰ e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, paraprakisht vlerëson të sjell në vëmendje legjitimitetin e tij mbi të drejtën për të ushtruar ankim edhe ndaj vendimeve të Komisionit, në rastet për të cilat nga ky i fundit, në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka evidentuar shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij.

12. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, shkeljet e evidentuara nga Komisioni, në rastin konkret, janë të tilla që nuk duhet të dalin jashtë juridiksionit të rivlerësimit, por duhen vlerësuar sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 4, pika 2 e të njëjtit ligj, për sa do arsyetohet në vijim.

IV.A. Kontrolli i figurës

13. Kontrolli i figurës, si një ndër tri kriteret e rivlerësimit kalimtar, ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme¹¹ me persona të përfshirë në krimin e organizuar¹² apo të atyre që kanë kryer deklaram të pasaktë¹³ të të dhënave, sipas përcaktimeve të nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe Kreut V të ligjit nr. 84/2016.

¹⁰ Shihni vendimin (JR) nr. 2/2020, paragrafët 15.2 deri 15.7, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹¹ Referuar pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, "kontakt i papërshtatshëm" është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit...

¹² Referuar pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, "person i përfshirë në krimin e organizuar" është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht... me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

¹³ Sipas nenit DH, pika 4, paragrafi dy: "Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën".

14. Kontrolli i figurës bazohet në deklaratën që plotësohet dhe dorëzohet nga vetë subjekti dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare dhe të huaja¹⁴. Në vlerësimin e këtij kriteri, rezulton se DSIK, pas raportit të parë, të dërguar më datë **.11.2017, hartuar pa përgjigjen e organit verifikues SHISH, ka dërguar raportin e dytë të përditësuar,¹⁵ në qershor të vitit 2021. DSIK, në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje përpara dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, duke arsyetuar që të merren parasysh elementet që evidentojnë përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme në formën e kontaktit/kontakteve të papërshtatshme, si dhe në veprimtari korruptive, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në *papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës* për këtë subjekt rivlerësimi.

15. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, sikundër kemi referuar edhe më sipër, ka administruar nga ONM, bazuar në germën b, të pikës 3, të nenit B, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 10 dhe 11, të ligjit nr. 84/2016, shkresën me objekt “Gjetje”. Kjo *gjetje*, ndër të tjera, referon se nga baza e të dhënave të sistemit TIMS, rezulton se subjekti i rivlerësimit, më datë ** janar 2017, ora 11:13, ka kaluar kufirin shqiptar me një automjet (***) në pronësi të shtetasit ***.*** (pronësia është konfirmuar nga baza e të dhënave të AMF-së), i cili rezulton të jetë dënuar nga Gjykata e Rimit, Itali, për 6 vepra penale¹⁶.

15.1 ONM, referon se pesë nga gjashtë veprat, për të cilat *** u shpall fajtor, duhet të konsiderohen sipas leximit të kombinuar të nenit 3(15) të ligjit nr. 84/2016 me nenin 3(1) të ligjit nr. 10192/2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, dhe janë të rëndësishme për procesin e rivlerësimit të këtij subjekti rivlerësimi.

16. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi nga hetimi i kryer ngrihen dyshime se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me shtetasin ***.***, person i përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me pikën 3, të nenit DH, të aneksit të Kushtetutës.

17. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka dhënë shpjegime se¹⁷: “... a) nuk kam qenë poseduesi i automjetit me targë ***; b) nuk kam qenë personi që ka marrë fillimisht automjetin me targë *** nga vendndodhja e tij fillestare, vendndodhje në të cilën mund të kishte kontakt me shtetasin ***.***; c) nuk kam përdorur asnjëherë automjetin me targë ***, por kam qenë vetëm në cilësinë e pasagjerit, çka provon pretendimin tim për mospërdorimin e drejtpërdrejtë të mjetit e, për pasojë, mospasjen e kontakteve me shtetasin

¹⁴ Paragrafi i dytë i nenit DH të aneksit të Kushtetutës.

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë **.6.2021, është dërguar raporti nr. *** prot., datë **.5.2021, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, e deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë **.6.2021.

¹⁶ Ky shtetas rezulton se është shpallur fajtor më ** janar 2016 nga Gjykata e Rimit - Ufficio G.I.P (në Itali), për 5 akuza për shitje të paligjshme të lëndëve narkotike dhe një akuzë për armëmbajtje pa leje, dhe është dënuar me 4 vjet e dy muaj paraburgim dhe gjobë prej 26.000 euro, si fajtor për veprat penale sa vijon: 1. Shitja e lëndëve narkotike, si vepër e vazhdueshme në ose rreth datës ** shkurt 2013...; 2. Shitja e lëndëve narkotike në bashkëpunim në ose rreth datës ** shkurt 2013...; 3. Shitja e lëndëve narkotike si vepër e vazhduar, në shkurt dhe mars 2013...; 4. Shitja e lëndëve narkotike si kundërvajtje e vazhduar në ose rreth datës ** prill 2013...; 5. Mbatja e paligjshme e armëve deri më ** prill 2013...; 6. Shitja e lëndëve narkotike si kundërvajtje e vazhduar, më ** maj 2013... Vendimi i sipërpërmendur ka marrë formë të prerë dhe detyruar më ** nëntor 2016.

¹⁷ Për më tepër referohuni shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

.. *Pretendimi se unë si subjekt rivlerësimi duhet të isha në dijeni të faktit që automjeti me targë *** ishte në pronësi të një personi të përfshirë në veprimtari kriminale, është i pambështetur nga provat e administruara nga vetë Komisioni dhe nga ato të relatuara më lart. Pretendimi i qenies fakt publik i ekstradimit të shtetasit ***.*** dhe, për pasojë, edhe dijenisë së subjektit të rivlerësimit mbi veprimtarinë kriminale të këtij shtetasi, është i padrejtë dhe i pambështetur...”. Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka depozituar edhe dy deklarata noteriale: (i) deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë *.5.2023, e shtetasit ***.***¹⁸, si dhe (ii) deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë *.5.2023, të shtetasit ***.***.¹⁹ Komisioni, në përfundim, ka çmuar se nuk disponohen elemente të mjaftueshme provueshmërie për të përmbushur rrethanat e parashikuara në pikën 4, rrethana këto që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me standardet e kontrollit të figurës, sipas nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, duke vlerësuar kështu se subjekti i rivlerësimit, A. Ismajlukaj, ka plotësuar saktë deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

18. Komisioneri Publik, mbështetur në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së dhe përmbajtjes së *Gjetjes* së vëzhguesit ndërkombëtar, çmon se përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni në vendimin e tij, vlerëson se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me shtetasit e përfshirë në rrethanat faktike të dokumentuara së bashku me informacionin e disponuar nga organet ligjzbatuese, janë të tilla që ndikojnë në perceptimin publik të figura e magjistratit, sikurse dhe në besimin që duhet të ruajë sistemi i drejtësisë në tërësi, të dhëna, që në rastin konkret nuk mund të lihen jashtë vlerësimit tërësor të çështjes. Ky është dhe qëllimi dhe fryma e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës, e cila kërkon që procesi i rivlerësimit të identifikojë gjyqtarët e prokurorët, të cilët kanë integritet të cenuar, duke i përjashtuar ata nga sistemi i drejtësisë. Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, referuar rrethanave të rezultuara nga kontrolli i figurës, në konsideratë dhe të përmbajtjes së *Gjetjes* të paraqitur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar i çështjes, si dhe Rekomandimit të ONM-së, vendos në vëmendje të Kolegjit se:

¹⁸ Në këtë deklaratë, shtetasi ***.***, ndër të tjera, deklaroi se: “... në lidhje me automjetin me targë ***, me të cilin rezultoi nga sistemi TIMS hyrje - dalje nga pika e kalimit kufitar Qafë-Morinë të Rrethit Tropojë, më datë *.01.2017, së bashku me shtetasin A. Ismajlukaj dhe disa të afërm të tij, kam për të thënë se ky automjet ka qenë në përdorim nga ana ime për një periudhë shumë të shkurtër kohore. Këtë automjet e kam marrë nga shtetasi ***.***, të cilin e kam djalin e dajës tim. ..Gjithashtu kemi dalë në pikën e kalimit kufitar Qafe-Morinë të Rrethit Tropojë më datë *.01.2017, në drejtim të Kosovës, së bashku me shtetasin A. Ismajlukaj dhe kolege dhe disa persona me lidhje shoqërore, ku kemi qenë të ftuar për drekë nga shtetasi ***.*** dhe, pasi kemi mbaruar drekën, përsëri jemi kthyer në të njëjtin itinerar. Shtoj se ky automjet është përdorur nga ana ime dhe shtetasi A. Ismajlukaj nuk ka pasur asnjë lidhje me këtë automjet, kjo lehtësisht e provuar, pasi unë kam hyrë në territorin e Shqipërisë dhe pikërisht në Tropojë nga pika e kalimit kufitar Qafë-Morinë të Rrethit Tropojë më datë *.01.2017.. Gjithashtu shtoj se nuk e njoh pronarin e automjetit me targë ***”.

¹⁹ Në këtë deklaratë, shtetasi ***.***, ndër të tjera, deklaroi se: “... automjetin me targë *** ia kam marrë shtetasit ***.***, me qëllim për ta përdorur disa ditë dhe datën e saktë nuk e mbaj mend, por di që ka qenë muaji janar i vitit 2017 dhe te shtëpia ime në Mamurras ka ardhur çuni i hallës time, ***.***, i cili më ka thënë se po ikte për në Tropojë e ka marrë e ka mbajtur disa ditë dhe e ka kthyer. Shtoj se shtetasi ***.*** nuk ka asnjë lidhje me shtetasin ***.*** dhe nuk e njeh”.

(i) Nga baza e të dhënave TIMS rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit, më datë ** janar 2017, ora 11:13, ka kaluar kufirin shqiptar me një mjet me targë *** në pronësi të shtetasit ***.***, dhe i drejtuar nga shtetasi ***.***.

(ii) Shtetasi ***.***, bazuar në burime të hapura të informacionit, rezulton një emër i njohur nga drejtësia shqiptare, i shpallur fajtor më ** janar të vitit 2016 nga Gjykata e Rimini-Ufficio G.I.P- (në Itali), për 5 akuza për shitje të paligjshme të lëndëve narkotike dhe një akuzë për armëmbajtje pa leje, duke u dënuar me 4 vjet e dy muaj burgim dhe gjobë prej 26.000 euro.

(iii) Në legjislacionin tonë të brendshëm, prodhimi, shitja dhe trafikimi i narkotikëve janë vepra penale të parashikuara në nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal, të cilat të dyja përfshihen në listën e veprave penale të parashikuara nga neni 3, pika 1, e ligjit nr. 10192/2009, të cilit i referohet neni 3, pika 15, e ligjit nr. 84/2016, për të përcaktuar kategorinë e “personave të përfshirë në krimin e organizuar”.

(iv) Aktiviteti penal për të cilin është dënuar shtetasi ***.***, shtrihet midis periudhës 2013-2014, pavarësisht se përgjegjësia penale e tij është përcaktuar me vendim të formës së prerë në vitin 2016. Në këto rrethana, për shkak të pozitës së subjektit, kontakteve dhe njohjeve të tij të ngushta në Tropojë, nuk duket bindës pretendimi i subjektit se nuk ka qenë në dijeni të ngjarjeve që lidhen me shtetasin ***. Gjithashtu, nga aktet ka rezultuar se me automjetin me targë ***, në pronësi të këtij shtetasi, kanë udhëtuar dhe shtetas të tjerë, me të cilët subjekti i rivlerësimit rezulton se ka lidhje familjare dhe shoqërore. Në përgjigjet e pyetësorit 3, më datë 23.11.2022, subjekti i rivlerësimit deklaroi se me shtetasit ***.*** dhe ***.*** ka lidhje familjare. Po ashtu rezulton se me automjetin e mësipërm ka udhëtuar dhe shtetasi ***.***, djali i xhaxhait të subjektit.

18.1 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së dhe të jurisprudencës së Kolegjit, çmon se vendimi nr. 681/2023 i Komisionit duhet vlerësuar në tërësi, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, pasi rezultojnë disa rrethana, të cilat të analizuar së bashku e të para në raport me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje dhe qëndrim të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i atij sistemi. Rrethanat e dala nga kontrolli i figurës, ndonëse nuk çojnë në kualifikimin e subjektit, si të papërshtatshëm në kuptim të këtij kriteri, të marra së bashku me rrethanat e tjera të trajtuara gjerësisht në ankim dhe në Rekomandimin e ONM-së, tregojnë mjaftueshëm elemente që vijnë në kundërshtim me vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, të vendosura në themel të mbrojtjes dhe forcimit të besimit të publikut, duke krijuar kështu premisat e duhura për një vlerësim tërësor sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

IV.B. Gjetje të tjera

19. Nga aktet e administruara, rezulton se Komisioni, gjatë hetimit administrativ shtesë, sipas informacionit të administruar nga organet ligjzbatuese, nga të cilat është njohur lidhur me “Fenomenin e kultivimit të cannabis sativa në vend”, ka hetuar edhe për disa shtetas,

konkretisht shtetasin: (i) ***.***; (ii) ***.***; (iii) ***.***; (iv) *** e ***.*** dhe (v) ***.***²⁰.

20. Nga hetimi, bazuar dhe në të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS, Komisioni ka konstatuar shoqërimin e subjektit me persona të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme dhe të dënuar për vepra penale, duke i vlerësuar fillimisht si situata të cilat ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes së magjistratit, etikën e tij në punë dhe angazhimin ndaj vlerave, referuar ligjit nr. 84/2016 si dhe nenit 75, të ligjit nr. 96/2016, për të cilët i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, për sa do trajtohet në vijim.

21. Komisioni ka hetuar lidhur me një automjet të tipit BMW, për të cilin ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur vetëm një herë. Ky automjet (targa ***), ka qenë në pronësi të shtetasës znj. ***.***, me përdorues ***.***dhe ***.***, vëllezërit e subjektit të rivlerësimit²¹. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se ky automjet është përdorur gjithashtu dhe nga shtetasi ***.***.

21.1 Po ashtu, nga sistemi TIMS, rezulton se subjekti ka udhëtuar dhe ka përdorur automjetin me targë ***, i llojit “Seat”, në pronësi të shtetasit ***.***, automjet me të cilin rezulton se ka udhëtuar dhe shtetasi ***.***.

21.2 Komisioni ka administruar informacion nga Prokuroria Tropojë²² dhe Gjykata Tropojë²³, të cilat kanë informuar se janë evidentuar kallëzime penale të regjistruara dhe procedime penale, në ngarkim të shtetasit ***.***, si më poshtë:

(i) Procedim penal nr. ***, i vitit 2005, regjistruar për veprat penale “Vrasje me paramendim mbetur në tentativë”, “Shkatërrim prone me eksploziv dy herë”, “Mbajtja pa leje të lëndëve plasëse”, të parashikuar nga nenet 78-22, 152, 278/2 të K. Penal (Dëmtim i lokalit i shtetasit ***.***), dosje e pezulluar;

(ii) Procedim penal nr. ** i vitit 2012, për veprën penale “Plagosje e rëndë nga pakujdesia” dhe “Mbajtja pa leje të armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga nenet 91 dhe 278/2 të K. Penal, në ngarkim të shtetasit ***.***, dosje e gjykuar.

21.3 Komisioni, referuar dosjes hetimore që i përket procedimit penal nr. ***/2012 për rastin e hetimit të shtetasit ***.***, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në cilësinë e Oficerit të Policisë Gjyqësore. Në këtë cilësi, subjekti ka hartuar procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, si dhe procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale (kallëzuesi), si dhe dëshmitarët. Prokurori i çështjes ka qenë z. ***.***²⁴.

²⁰ Nuk rezulton që subjekti të ketë udhëtuar me këtë shtetas. Sipas të dhënave në TIMS nuk ka rezultuar të ketë ndonjë shkelje të ligjit nga ky shtetas. Referuar sistemit TIMS, z. ***.*** ka udhëtuar me automjetin me targa ***, gjatë periudhës 2013 – 2014, në pronësi të shtetasit ***.***.

²¹ Nga regjistri i gjendjes civile rezulton se ***.*** dhe ***.*** janë vëllezërit e subjektit të rivlerësimit. Ky automjet ka qenë në pronësi të shtetasës ***.*** për periudhën 2013 – 2016. Pas këtij viti, ky mjet ka kaluar në pronësi të shtetasve të tjerë, me të cilët nuk rezulton që subjekti të ketë udhëtuar.

²² Me shkresën nr. *** prot., datë **/2.2023.

²³ Me shkresën nr. *** prot., datë **/3.2023.

²⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. **, datë **/12.2012, ka vendosur: 1. Pushimin e çështjes penale për veprën penale “Plagosje e rëndë nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 91 i K. Penal, për shkak se kjo vepër penale ishte

21.4 Në lidhje me këtë shtetas,²⁵ subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se: “...Shtetasin ***.*** e njoh dhe me vëllain e tij shtetasin ***.*** kam marrëdhënie shoqërore, pasi kemi qenë në shkollë bashkë. Në lidhje me procedimin penal në ngarkim të këtij shtetasi kam qenë Oficeri i Policisë Gjyqësore i deleguar për kryerjen e veprimeve hetimore. Në lidhje me këtë rast kam vënë në dëgjim Drejtuesin e Prokurorisë në atë kohë që ishte njëkohësisht dhe prokurori i çështjes për lidhjen që kisha me vëllain e këtij personi, por duke qenë se isha i vetmi Of. Pol. Gjyqësore ..., ky procedim penal më është deleguar mua. Nga ana ime janë kryer të gjitha veprimet e duhura hetimore sipas urdhrit të delegimit të veprimeve nga prokurori i çështjes...”.

21.5 Komisioni, në përfundim, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në fazën hetimore dhe në atë gjyqësore, është njohur me veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit dhe vendimin e gjykatës dhe nuk ka kryer veprime që të dëshmojnë kundërshtime apo kërkesa në lidhje me procedimin penal, veprimet hetimore dhe vendimin e gjykatës. Për sa më sipër, veprimet e subjektit të rivlerësimit, të konfirmuara edhe nga vendimi i Gjykatës, provojnë se ky i fundit është sjellë në përputhje me etikën e oficerit të policisë gjyqësore, zbatimin korrekt të ligjit dhe shmangien e konfliktit të interesit [...].

21.6 **Komisioneri Publik**, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, si dhe rezultateve të hetimit, vlerëson se dhe në rastin e mësipërm, hetimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet e ekzistencës së marrëdhënies miqësore, në kufijtë e pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, është një sjellje e cila më së paku ndikon në perceptimin negativ të qytetarëve në integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë. Ky element në tërësi me rastet e tjera të rezultuara, qoftë edhe në mungesë të konfliktit të interesit, ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit ndaj shkelësve të ligjit, çka bën që ndaj subjektit të rivlerësimit të rëndojë edhe parashikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e subjektit lidhur me njoftimin e Drejtuesit të Prokurorisë apo prokurorin e çështjes, se kishte njohje me shtetasin ***.***, mbeten në nivel deklarativ, pasi nga aktet nuk duket se subjekti i rivlerësimit ka sjellë ndonjë dokument provues.

22. Komisioni, në analizë të të dhënave të sistemit TIMS, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka dy dalje²⁶, edhe me automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasit ***.***, ndërkohë që rezulton se ky shtetas ka hyrje në Shqipëri në të njëjtën datë. Po ashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka 1 udhëtim²⁷ me automjetin me targa ***, në pronësi po të këtij shtetasi. Nga hetimi ka rezultuar se me automjetin me targë *** ka udhëtuar²⁸ dhe shtetasi ***.***. Nga aktet rezulton se ky automjet ka qenë në pronësi të shtetasit ***.*** dhe përdorues ***.***, nga viti 2011 - 2016.

amnistuar me ligjin nr. 107/2012, datë 8.11.2012, shpallur me dekretin nr. 7824, datë 19.11.2012, të Presidentit të Republikës.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit ***.***, për veprën penale “Mbajtja pa leje të armëve dhe municionit luftarak”, parashikuar nga neni 278/2 të K. Penal, dhe dënimin e tij me 10.5 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406, të K. Penal, i pandehuri dënohet përfundimisht me 7 muaj burgim... Ky vendim ka marrë formë të prerë në dt. **12.2012.

²⁵ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me email-in e datës 23.11.2022.

²⁶ Referuar rezultateve të hetimit dhe sistemit TIMS të administruar në dosje të Komisionit, të dhënat i përkasin datës **2.2014 dhe datës **12.2013.

²⁷ Referuar TIMS, datë **12.2013.

²⁸ Datë **6.2012.

22.1 *Lidhur me shtetasin ***.***, Prokuroria Tropojë ka informuar Komisionin se janë evidentuar kallëzime penale të regjistruara dhe procedime penale në ngarkim të tij, si vijon: (i) Procedim penal nr. ***, i vitit 2007, regjistruar për veprat penale “Kontrabanda me mallra të tjera”, në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 174-25 të K. Penal, në ngarkim të pandehurve ***.*** dhe ***.***, dosje e gjykuar; (ii) Procedim penal nr. ** i vitit 2010, regjistruar për veprën penale “Shkatërrim i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i K. Penal, në ngarkim të pandehurit ***.***, me kallëzues shtetasin ***.***, dosje e gjykuar; si dhe (iii) Mosfillimi i procedimit penal nr. ***, i vitit 2019, referuar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i K. Penal, në ngarkim të shtetasit ***.***.*

22.1.1 Nga aktet ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është përfshirë në veprimet hetimore, në cilësinë e Oficerit të Policisë Gjyqësore (OPGJ-së), në procedimin penal nr. ***/2007. Subjekti i rivlerësimit ka hartuar dhe nënshkruar disa akte procedurale²⁹. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. ***, datë **.12.2007, ka gjetur fajtor dhe dënuar shtetasin ***.*** dhe një shtetas tjetër për veprën penale të “Kontrabandës me mallra të tjera në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 174-25 të K. Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën **.12.2007.

22.1.2 Lidhur me këtë rast, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “...Me shtetasin ***.*** kam marrëdhënie shoqërore dhe qëllimi i udhëtimit me automjetin e tij ka qenë me qëllim për të shkuar në Tiranë dhe anasjelltas, pasi mundësitë për të lëvizur në orare të ndryshme kane qenë të kufizuara, pasi linjat e udhëtimit kanë pasur orare fikse në orët e mëngjesit dhe nuk kishte pas orës 12.00 dhe, në këtë mënyrë, ishte e pamundur që të lëvizje në drejtim të Tiranës dhe anasjelltas”.

22.2 *Lidhur me shtetasin ***.***, Komisioni ka kërkuar informacion pranë Dr. Përgjithshme të Burgjeve për gjendjen gjyqësore³⁰, nga ku ka rezultuar se ky shtetas ka qenë i dënuar për disa vepra penale, të mashtrimit, të largimit të dënuarit nga vendi i ngjarjes, i drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt, mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik, vjedhje, përvetësim të titullit apo detyrës shtetërore, si dhe vjedhje me dhunë. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit shtesë, lidhur me këtë shtetas, ka prapësuar se nga aktet e hetimit administrativ nuk gjendet asnjë lidhje apo kontakt i drejtpërdrejtë me të.*

23. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se gjatë vitit 2016, ka pasur në përdorim automjetin në pronësi të shtetasit ***.***, me targë ***. Në përgjigjet e pyetësorit 3, më datë 23.11.2022, subjekti i rivlerësimit deklaroi se me shtetasin ***.*** dhe ***.*** ka lidhje familjare.

²⁹ “Procesverbalin e Pyetjes së Pandehurit”, të datës **.10.2007; Procesverbalin për Njohjen e të Pandehurit me materialet e çështjes”, të datës **.10.2007; “Procesverbalin për dorëzimin e provës materiale të përfituar nga shitja”, datë **.10.2007; “Procesverbalin për shitjen e provës materiale”, datë **.10.2007; “Procesverbalin për lënien në ruajtje në bankë të vlerës monetare të sekuestruar”.

³⁰ Referuar shkresës nr. ***, datë **.6.2023.

23.1 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve³¹ ka informuar se shtetasi ***.***, me vendimin nr. **, datë **.2.1992, të Gjykatës Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale të “Vjedhjes së Pasurisë Shtetërore”...

23.2 Nga aktet rezulton se me automjetin në pronësi të shtetasit ***.***, me targë ***, ka udhëtuar dhe shtetasi ***.***. Subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me këtë shtetas, me automjetin në përdorim të tij me targa ***, në pronësi të ***.***, në datë **.9.2016. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve³² ka informuar se shtetasi ***.***, me vendimin nr. **, datë **.1.2007, të Gjykatës Tropojë, është deklaruar fajtor për veprën penale të “Plagosjes së Lehtë me Dashje” dhe “Plagosjes me dashje të kryer në bashkëpunim...” si dhe me vendimin nr. **, datë **.7.2008, të Gjykatës Tropojë, është deklaruar fajtor për veprën penale të “Goditje për shkak të detyrës kryer në bashkëpunim...”.

23.3 Për shtetasin ***.***, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... ka njohje dhe lidhje familjare me të dhe se pretendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dijeni për vendimin e dënimit të vitit 1992, kohë në të cilën nuk jetonte në Tropojë dhe ishte në moshën 13-vjeçare, nuk është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka pasur kontakte me shtetasin ***.***, në një kohë shumë të mëvonshme se vendimi i tij i dënimit, e për më tepër në një periudhë në të cilën ky shtetas rezulton i rehabilituar. Ndërsa për shtetasin ***.***, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... kam njohje me këtë shtetas për shkak të lidhjes familjare që ky i fundit ka me shtetasin ***.***. Me përjashtim të udhëtimit të datës **.9.2016, nuk ka takime të tjera me këtë shtetas. Për sa i përket udhëtimit të datës **.9.2016, theksojmë se ky udhëtim është kryer për nevoja personale të tij dhe për shkak të përdorimit të automjetit të shtetasit ***.***, është marrë shtetasi ***.***, në cilësinë e drejtuesit (shoferit) të automjetit.

